

RÉKA MÁN-VÁRHEGYI
KODRA MAGNETIKE

ROMAN

BOTIMET TOENA

RÉKA MÁN-VÁRHEGYI

KODRA MAGNETIKE

roman

Përktheu nga origjinali hungarisht
Irir Qorri

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2022

Autori: Réka Mán-Várhegyi (Reka Man Varhegyi)

Titulli në origjinal: Magneshegy

Botoi në hungarisht: Magvető Könyvkiadó



Me bashkëfinancimin e Programit
“Europa Krijuese” të Komisionit Europian.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Eglantina Hilaj

Përkujdesja grafike: Edona Marku

© e imazhit në kopertinë: Lidia Keçaj

ISBN 978-9928-376-07-7

© Réka Mán-Várhegyi, 2018

© *në shqip* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Çfarë vizioni vetmie dhe rebelimi na shpalos figura e Margaret Kavendish-it! Dukej si një kastravec që ka nxjerrë kokën përmbi trëndafilat dhe karafilat e kopshtit, ndërkohë që ka mbytur disa prej tyre. Çfarë humbjeje është kur një grua, që mendon se “gratë më të mira janë ato që e kanë mendjen të nënshtruar”, i harxhon ditët e veta duke shkarravitur çmenduria dhe duke u zhytur thellë e më thellë në zymtësi e marrëzi, derisa njerëzit t’i vijnë rrotull shilarësit të saj se ndoshta zbret që aty. Është e qartë, princesha e brumbullit është kthyer në dordolec për të mundësuar trembjen e vajzave të zgjuara.

Virginia Woolf “Dhoma ime”

1.

Ata që janë pjesë e kësaj historie i kam njohur në një konferencë të zhvilluar në rrethina. Është një pasdite maji, disi e ngrohtë, e vitit 2000. Jemi në një qytet në lindje të Hungarisë dhe vendi i konferencës është në një ndërtesë të paraqitshme në sheshin kryesor të qytetit, ndoshta është ndërtesa e bashkisë. Nga diku aty pranë dëgjohet lehtë zhurma e një kambane dhe unë, duke nxjerrë kokën fshehtas nga dritarja prapa, dalloj se si kanë lulëzuar në kopsht portulat, manushaqet, vjollcat, oleandrat.

Në sallonin e gjatë ishin vendosur të paktën njëzet radhë me karrige, pesë a gjashtë për çdo radhë. Ulem në fund, sepse ndiej që nuk dua të zihem për radhët e para, pasi vetëm disa muaj më parë mora emërimin në botën e shkencave shoqërore dhe më duhet të punoj edhe vite të tëra që të nxjerr në dritë rezultate të prekshme. Për momentin as që e imagjinoj se një ditë të bukur do të ngrihem në podium dhe do të më duhet të shpjegoj rezultatet e punëve të mia shkencore. Për fat të keq nuk i shoh mirë fytyrat. Shkaku kryesor është se nuk i mbaj syzet. I kam këtu në çantë, por i vendos kur më duhet të lexoj ndonjë gjë nga larg, për shembull titrat e filmit në kinema ose kur pedagogu shkruan diçka në dërrasë gjatë leksionit. Në universitet përpiqem të ulem më tepër diku përpara.

Lektorët e seancave të deritanishme kanë qenë pa përjashtim burra të moshuar. As vetë nuk e kuptoj nga e marr guximin, por i bëj disa komente të zëshme shokëve të mi të kursit të ulur afër meje, për pabarazitë gjinore dhe moshore që janë të dukshme në konferencë, madje i kam përmendur se ndërkohë kur raporti i grave, që studiojnë në këtë degë, është të paktën gjashtëdhjetë për qind, deri në këtë moment për lektorët është saktësisht zero. Shokët e mi të kursit po zhurmojnë, buzëqeshin me përzemërsi, vetëm një vajzë rrudh buzët, me shumë mundësi për të më vënë në dukje se ndan të njëjtin mendim me mua, por në të njëjtën

kohë i duket qesharake që dikush ta deklarojë këtë kaq thjesht me zë të lartë. Nuk e kuptoj se çfarë do të më këshillonte, më mirë të vazhdonim të dëgjonim apo të bënim fiks të kundërtën, që të vepronim më fuqishëm, por megjithatë më pushton ndjesia e turpfit që ishte kultivuar rregullisht brenda meje. Fytyra e vajzës më mbeti e fiksuar për një periudhë të gjatë.

Më kujtohet se gjatë leksioneve të paradites arrija të ruaja vëmendjen, ndërsa në ato të pasdites vëmendja ulej, e sidomos pas drekës së konferencës - supë mishi me makarona fidhe, pulë e piperosur me nokedli, pure gështenjash me shllak - më ngushton fundi që kam mbajtur gjatë provimeve me gojë të pranimit dhe atyre të laurimit, ndërsa gjoksin ma shtrëngon këmisha e bardhë e hekurosur.

Leksionin “Përballë njëri-tjetrit - sllovakë e hungarezë” e jep një lektor i shkurtër me tipare këndore nga Mishkolci, ndërsa lektori pas tij mban leksionin “Teori nacionalizmi në ndërrimin e mijëvjeçarëve” dhe të dy grijnë sallatë, kështu që nuk kuptoj goftë edhe një fjalë të vetme.

- Këto relikte të lashta nuk dinë fare të japin leksione, - pëshpërit dikush që e kam afër. Është fakt që shumica i lexojnë leksionet shpejt e shpejt, pa asnjë theks, duke i varrosur në shënimet e tyre. Nxitimi kuptohet, pasi teksti është përherë më i gjatë se njëzet minutat që kanë në dispozicion.

Disa radhë para meje është ulur Levente Vadkerti, kolegu i paralelit tim, që prej muajsh i mbush mendjen të gjithëve se ka rënë në dashuri me mua. Në fund të semestrit u bëmë shokë të të njëjtit vit shkollor dhe ndoshta kjo ia ndezi zjarrin në zemër. Levente është tip i gjatë dhe me trup sportiv, kurse unë jam e shkurtër dhe e shëndoshë. Në fakt, jemi mirë me njëri-tjetrin. Shpesh bashkë shkojmë e ndezim nga një cigare te dritarja, shkojmë te bari, ndonjëherë edhe ulemi për kafe, ose rrimë të strukur, në një prej stolave të kopshtit të Muzeut, dhe debatojmë për ato që kemi dëgjuar në leksione apo seminare. Levente ka humor të këndshëm, është i orientuar, lexon të përjavshmet më të rëndësishme. Kurse tani kthen kokën herë pas here dhe tregon me grimasa të ndryshueshme se ç’mendim ka për lektorin në fjalë, ndërsa unë nuk reagoj, por edhe nuk dua të më shohë që po më zë gjumi.

- Nevojitet pak oksigjen, dikush le të hapë pak dritaren, - thërret një vajzë aty pranë, dhe thua se dikujt sapo i ka ardhur ndër mend se zëri urdhërues, thyen monotoninë e njëtrajtshme të leksionit, duke e kthyer fundin e fjalisë gati në formë kërcënimi. Nuk e ndiej që të më kenë thirrur mua, shoh rreth e përqark si e zënë në faj, ashtu si edhe të tjerët. Me pak vonesë kacavirret një vajzë e shëndoshë dhe kërkon dorezën e dritares, kurse lektori pushon dhe bën të duket që mund të flasë vetëm kur të gjithë sytë t'i drejtohen atij dhe kështu nuk ka më asnjë rrethanë penguese. Më në fund shohim kanatën e dritares të hapet deri në fund, dhe disa prej nesh ulin kokën për të parë nga rruga.

Dy flutura të verdha po rrotulloheshin aty përreth a thua se prisnin t'u jepej lejë të futeshin në sallën e konferencës. Të duket sikur në ndjekje të tyre janë zhurmat e ndryshme që vijnë nga jehona e ujitësit që e hedh ujin tej në kopsht. Jo larg uji vërshon edhe nga një shatërvan. Zemrën ma përshkon paqja. Lektorin nuk e dëgjoj më, më vijnë mendime dhe i them vetes: *Reka, je në vendin e duhur*. Imagjinata më shfaq pamjet e një realiteti të mundshëm. Buzë bregut të liqenit, fëmijë me zërat buçitës, aroma e misrave të zier. Në gjysmëndrrën ku ndodhem, e ulur pranë bregut në një stol të bardhë plastik, sipër meje valëzojnë nga era degët e shelgjeve dhe valanidhit. Nga rruga në drejtim të ujit vijnë njerëz të moshuar, gra e burra me rroba banje, në kokë mbajnë kapela kashte dhe shami të lidhura në cepat e tyre. Vijnë zbathur deri në fund të rrugës me kalldrëm, shputat u janë regjur tashmë, trupat i kanë gjithnjë të nxirë, sepse prej dekadash kalojnë këtu çdo verë. Mbërrijnë në breg nga rrugicat aty pranë e në këto çaste nuk marrin me vete as peshqirë, por kanë vetëm nja dy lodra plazhi që fryhen, një kamerdare si patë dhe një dinozaur të nipit a të mbesës së tyre. Ecin me hap të njëjtë, të pandryshuar, kalojnë krah meje me fytyrat që nuk pasqyrojnë ndonjë entuziazëm, madje asgjë, dhe kështu vazhdojnë përpara drejt liqenit.

Koka më bie përpara, zgjohem. Shoh ende se si fillon të kërcëjë nga dora që pushon mbi prehër njëra prej fluturave të verdha. Levente Vadkerti buzëqesh, kurse disa të tjerë kthejnë vështrimin nga unë. Ndoshta po skuqem. Kam vapë.

Lektori është një pesëdhjetëvjeçar nga Peçi, ndoshta edhe ai ka kohë që po flet. Tema bën fjalë për kinezët që jetojnë në Hungari, por mundet të jetë për armenët. Radhit të dhëna, shifra e përqindje, duket sikur lexon disa faqe me tabela. Sipas programit, tani duhet të ishte radha e dikujt që paraqet mësimet e analizës së himnit krahasues, por ky njeri i ndrydhur nga Peçi nuk e nxjerr asnjëherë nga goja fjalën himn. Mundet që ai i himnit të mos ketë mbërritur ende dhe prandaj kanë mbajtur përpara këtë të Peçit me kinezët. Apo me armenët.

Kalon një kohë e gjatë derisa lektori nga Peçi falënderon për vëmendjen dhe ulet.

- Nga ky seksion kanë mbetur vetëm dy lektorë, - ngrihet e thotë moderatori. Sheh orën dhe përllogarit. - Sipas planifikimit, jemi me dyzet minuta vonesë. Do të ishte e rëndësishme që nga ky çast vërtet të kujdesemi për kohën që ka secili në dispozicion.

Në podium ngjitet një grua. E njoh, sepse gjatë pushimit të drekës ishte në radhë përpara meje në tualet. Mbeta gojëhapur nga veshja e saj - xhaketën kadife ngjyrë kafe të thellë, pantallonat me ngjyrë blu verbuese, që ndonëse ishin xhins, prapëseprapë mbeteshin elegante. “Mund të jetë e huaj”, mendova. Ndërkohë që ishim duke pritur, hiqte vetullat. Çantën prej kamoshi e mbante shtrenguar nën sqetull dhe në njërin dorë mbante pasqyrën e xhepit, kurse në tjetrën pincetën e vetullave. Kërkonte rrezin e dritës që futej nga dritarja e vogël dhe meqenëse çanta i rrëshqiste vazhdimisht poshtë, përpiquej ta mbante, që të mos i binte, duke u shtyrë me kofshën në mur. Kur e mbaroi heqjen e vetullave, vështroi me vëmendje rezultatin e punës, e më pas kontrolloi flokët. Vështrimet tona u puqën nëpërmjet pasqyrës së xhepit. U kthye drejt meje dhe e surprizuar vërejta se sytë i kishte të kuq, ndërsa përgjatë kontureve të hundës kishte një lëkurë të çarë nga një ngjyrë lejla e errët; fytyrën e kishte të munduar, ose të paktën të krijonte përshtypjen e lodhjes.

Në tualetin e vetëm, që punonte prej kohësh, ka pushuar zëri i rrjedhjes së ujit, pra mbizotëronte qetësi absolute a thua se i fundit që kishte qenë aty, sipas të gjitha gjasave, të kishte avulluar ndërkohë. Pastaj ky dikush lëshoi një tingull mërzie të stërzgjatur. Zëri i hollë dhe i ndrojtur tregonte se personi po përpiquej me të

gjitha forcat ta largonte mërzinë, mirëpo pikërisht për këtë shkak, ai zë bëhej, me të vërtetë, shumë i padurueshëm dhe dukej se po zgjaste shumë, a thua të ishte një qen që po shihte ëndërr.

- Nuk duroj dot, - tha gruaja me xhinse e xhaketë. Vështrimi i saj përshkoi fytyrën time, pata një ndjesi sikur ishte e nxehur për shkakun tim, sikur të isha unë që po i merrja radhën e tualetit. Vari çantën në trupin e kaloriferit dhe duke më shtyrë lehtas, nxitoi për te lavamani, por më pas sikur ta kishte rimenduar veprimin e mëparshëm, u kthye mbrapsht vetëm për të marrë çantën. - Kalo përpara, - më tha, më shtyu sërish për herë të tretë, e pastaj shkoi te një lavaman dhe hapi ujin.

Nga WC-ja doli jashtë një zonjë që po shfrynte. Me vështirësi sforcoi trupin për nga kabina, duke mbajtur në duar pjesën e sipërme të kostumit, çantën, pardesynë dhe qesen me disa kuti tualeti. Ndoshta shkak u ishte qesja apo pjesa e sipërme e hekurosur e kostumit, që më bëri të mendoja se mund të jetë tipi i atyre zonjave që i kushtojnë gjithë vëmendjen higjienës, ndërkohë që nuk i zhvillojnë kurrë aftësitë e tyre koordinuese dhe kështu me kalimin e moshës hapësirat jo vetëm të ngushta, por edhe të ndotura, u shkaktojnë sfida të mëdha.

- Nuk është në rregull tualeti tjetër? - më pyeti sikur donte të më zinte në faj. Natyrisht, besoj se ka menduar që isha unë personi që *nuk duron dot*.

- Jo. Nuk punon, - iu përgjigja. - Është e shkruar.

Në kabinë vura re që po më dridheshin duart, si çdo herë asokohe kur ndodhesha në situata tensioni. Jashtë sikur gjëmonte uji. Nga zërat dola në përfundim se gruaja më e re po shpëlante të gjithë trupin. E hidhte, e spërkaste, e kalonte gjithandej ujin në trup, pastaj mori frymë sikur po përgatitej të zhytej. Mendova se të tilla zhurma profane fluskuese nuk mund t'i prodhojë dikush që ka xhaketë të tillë kafe të thellë dhe xhinse bojëqielli.

Gruaja e moshuar ishte zhdukur kur unë dola në pah. E njohura ime e re në këtë kohë ngriti kokën nga poshtë çezmës. Lavamani ishte plot me shkumë, kurse shishja e sapunit të lëngshëm gjendej e hedhur. Xhaketën kadife e kishte mes këmbëve, kurse çanta ishte në tokë. Xhinset i kishte me shenja uji.

- Lava kokën, - tha. Sipas gjasave, fjalët m'u drejtuan mua, pasi tjetërkush nuk ndodhej në tualet. - Nuk e duroj dot kur është e yndyrshme.

- Në fakt bën vapë, - iu përgjigja pas një hezitimi të shkurtër.

Shtrydhi ujin nga flokët e shkurtër dhe pastaj e tundi kokën si qeni kur shkund ujin nga trupi. DysHEMEJA u mbush plot me pikla uji. Më prekën edhe mua. Sinqerisht u çudita që nuk iu bë vonë fare për këtë.

Futi edhe disa herë duart nëpër flokë, pastaj me një fshirëse letre fshiu fytyrën, kraharorin dhe duart, pastaj vuri edhe nga një copë letër në të dyja sqetullat e saj.

- Kam pak emocion, - tha dhe lëvizi nga lavamani. - Radha jote.

Dhe tani ja ku është në podium. Flokët i janë tharë dhe i rrinë të gjitha të kthyer nga njëra anë sikur po frynte erë.

- Tema e leksionit tim nuk kuptohet dot vetiu, - filloi ajo. - Prandaj e konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme që të sqaroj fillimisht zgjedhjen e vetë temës dhe të shpjegoj pak a shumë se për çfarë bëhet fjalë.

Ka diçka nervoze dhe prekëse brenda saj, flet me zë të lartë dhe të ashpër, pas çdo fjale e përkul kokën drejt auditorit si ndonjë skelet apo sikur shkund duhanin. Nuk e ka të shkruar leksionin, ose të paktën jo çdo fjali të tij, mban në dorë një fletore shënimesh dhe herë pas here kalon faqet para-prapa e kërkon mes tyre. Sikur të ishte zënë në befasi, dukshëm paraqet sfidë përcaktimi se çfarë të theksojë e çfarë jo nga leksioni, çfarë të përmendë dhe çfarë të lërë jashtë krejtësisht. Nëpër fjali shtohen përherë e më tepër treguesit bombastikë. Ka mbi dhjetë minuta që flet, por menjëherë e dalloj që nuk po e kuptoj ende në lidhje me çfarë po flet.

Ata që janë ulur pranë meje fillojnë të pëshpëritin, e shoh që po shajnë leksionin. Në program titulli është: "Rrugëtime të drejta dhe të gabuara në praktikën kombëtare të analizave antisemite". Emri i lektores është Eniko Bërëndi. Është ndihmëspedagoge në universitetin ku studioj edhe unë. Nuk kam dëgjuar ende asgjë për të.

- Siç e thonë shumica, dhe ashtu siç e kemi dëgjuar tashmë, - pauzë, - apo jo, edhe nga Bela, antisemitizmi sot në Hungari

nuk është koncept zyrtar, apo edhe tradicionalisht, - pauzë, - këtë nuk e ndiejnë as shtresa shoqërore të prekshme, që konceptet antisemite të jenë pak a shumë të hijshme që të përdoren në grupe sociale. Në shumë vende dhe shumë shpesh lexojmë edhe se, - pauzë, - si në studime apo në shkrime gazetash e revistash, që sistemi imunitar i pjesës thelbësore të shoqërisë të jetë vaksinuar kundër antisemitizmit.

Sikur të përvidhet rreth temës së saj. Nuk e kuptoj nëse dëshiron t'i përforcojë apo t'i kundërshtojë thëniet e studimeve që citon, ndërkohë që për këtë të fundit dalloj se me plot gojën i flet fjalitë e formësuara. Ha disa fjalë dhe sikur t'i mbarojë fryma, bën një pushim. Më pas i përvishet prapë. I buzëqesh fytyra herë pas here, pa ndonjë rregull kohor. Ajo lloj buzëqeshjeje, me plot kuptim, tregon se është e qartë që pyetjen apo citimin që sapo ka përmendur, vetëm e ka zbukuruar pak, prandaj është e panevojshme ta trajtojë më tej, sepse të gjithë të pranishmit e kuptojnë përse bëhet fjalë dhe se pikërisht ashtu është, jo ndryshe.

E lë mënjanë pjesërisht stilin shkencor të zakonitë, karakteristik të shumicës së leksioneve, dhe e mbush boshllëkun me kthesa të tipit bisedë e drejtpërdrejtë. Kjo më pëlqen, megjithëse nuk jam e aftë ta përcaktoj nëse e bën me qëllim apo është thjesht pasojë e përgatitjes së ngutshme.

- Për shkak të kohës duhet ta lë jashtë njohjen me detajet e librit të përmendur, - pauzë, - ndonëse kjo është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme. Për të tillë tip antisemitizmi ka një mori shembujsh, - pauzë, - madje qindra e mijëra.

Shfryn hundët, ndërsa shaminë prej letre e zhubros brenda faqeve të fletores së shënimeve.

Moderatori ngrihet në mes të fjalisë, i ka sytë me rrathë nga lodhja e ditës, kurse në fytyrë ka një grimasë po ashtu lodhjeje dhe duke treguar orën deklaron se për pak i mbaron koha dhe duhet të shpejtojë. Eniko Bërëndi premton se nga ky moment do të përqendrohet te thelbi, lëviz faqet me vrull, fluturon shaminë e hundëve, po kujt i bëhet vonë, asaj i duhet të gjejë shënimet që duhet t'i theksojë patjetër brenda një minute e gjysmë, kaq i ka mbetur. I kalon me nxitim për t'i mbaruar.

Më pas flet një burrë. “Metodat antropologjike në studimet sociologjike” është titulli në program. Lektori është ndihmëspedagog në katedrën e sociologjisë. As me të nuk jam përballur kurrë. Është i fundit në radhë për sot, prandaj edhe apatia e audiencës fillon të thyhet. Fillojnë të shtrihen të gjithë ata që kanë mbetur në sallë. Personi është një mesoburrë, veshur me këmishë dhe pantallona ngjyrë bezhë, që shpëlahen te njëra-tjetra, sikur të ishte futur në kominoshe. Më ngec syri te shpatullat dukshëm të ngritura, gati vertikalisht. Rrëqethem, më kap neveria, por menjëherë e bind veten se kjo më ndodh vetëm ngaqë babai im i shkretë dikur ka qenë mësues fizikulture, i cili me besim e pasion, shpallte se trupat që nuk mirëmbahen si duhet nëpërmjet aktivitetit sportiv, meritojnë përçmim. Sa herë që shikonte në TV politikanë të shëndoshë, yje kinemash anoreksike apo drejtues emisionesh si pedanë kërcimi, i komentonte përherë në të njëjtën mënyrë: “edhe këtë e paskan përjashtuar nga gjimnastika”. Edhe për lektorin veshur me ngjyrë bezhë, këtë do të thoshte dhe bashkë me të, do të formonte opinionin e vet për shkencat shoqërore, nëse do ta përfaqësonin të tillë ameba. Megjithëse në krahasim me pedagogët e kërrusur të universitetit, ky njeri duket i lëvizshëm, madje elastik, sepse e ndryshon shpesh qëndrimin e trupit, bën gjeste të vrullshme, por e vërteta është që vetëm me duar, kurse bërrylat, parakrahët i mban në mënyrë të vetëdijshme ngjitur pas sqetullave si shpend krenar. Ndërkohë që diskuton për nuancat e metodave të analizës kuantitative, buzëqesh si xhaxhi mësues, që ngadalë dhe me kënaqësi të veçantë i jep prindërve të humbur në lumturinë e tyre lajmin se fëmija, drita e syve të tyre, nuk është aq i zgjuar sa ç’e mendojnë në të vërtetë. Një pjesë e audiencës nënqesh, kurse herë pas here disa ngrenë zërin duke bërë shaka mes tyre. Ecim përgjatë disa pjesëve të analizës së kohëve të fundit, të cilat përgjithësisht, përmes pyetjes së disa mijëra anketuesve, janë përpjekur të japin përgjigje për cilësitë ideologjike të të gjithë popullsisë dhe lektori ynë vërteton me shembuj bindës se rezultatet e arritura nuk kanë baza të shëndosha. Është thujse e pamundur për t’u ndërtuar një pyetësor në mënyrë të tillë që pyetjet të formulohen pa lënë vend për asnjë keqkuptim. Rruga e vetme për t’u ndjekur është puna në terren, natyrisht jo në

kuptimin siç e mendojnë baballarët themelues të antropologjisë kulturore, por se si, kësaj pyetjeje nuk i kthehet ta shtjellojë në leksion, megjithatë në publikimin e konferencës do të përpiqet që të dërgojë një material të tillë sqarues, sepse po të mos ketë kufizime do t'i rikthehet edhe kësaj çështjeje.

- Në minutën e vetme të mbetur po ju njoh vetëm me radhitjet, pa shpjegime të tjera, me përparësitë e analizës kuantitative, brenda asaj të punës në terren, të cilave këshilloj t'u kushtohet rëndësi edhe nga ana e kolegëve, që tashmë merren me analiza të njësisive të mëdha hulumtuese, - thotë, por në këtë kohë nga audienca ngrihet një vajzë, pastaj një tjetër, më pas edhe dy të tjera dhe nisen drejt podiumit. Kur në sallë dikush lëviz, del jashtë, hyn, këto veprime i bën me lëvizjet më të kujdesshme të mundshme që të mos pengojë leksionin. Por këto vajza nuk po sillëshin kështu. U kërkojnë falje me zë të lartë personave që u dalin përpara, kolliten, pastaj shpejtojnë po përpara sikur podiumi të ishte bosh dhe sikur për pak po vinte radha e tyre që të mbanin leksion. Kur mbërrijnë në destinacion, dy prej tyre ndalojnë në njërin krah dhe dy të tjera në anën tjetër të lektorit. Burri për një moment e lë renditjen e përparësive të punës në terren, por pastaj e vazhdon prapë menjëherë, ndonëse nëpërmjet fjalëve i krijohen tashmë pikëpyetje. Katër vajzat përballen pa drojë me audiencën, si heronj të filmave uestern në mes të sheshit të luftimit nga perëndimi i egër. Askush nuk interesohet se përse po e bëjnë këtë, sikur diçka duhet të ndodhë patjetër që të duket se këto vajza po pengojnë vazhdimin e leksionit. Njëra prej tyre papritur thërret me zë të lartë. Madje nuk është e folur, por thirrje luftarake. Menjëherë më pas, duke filluar nga e majta në të djathtë, vajzat heqin bluzat. Në gjoksmbajtëset e puthitura me kujdes duket sikur kanë realizuar një mbishkrim. Pa fjalë, qëndrojnë prapë pa lëvizur, sikur të presin që ndjekësit ulur të fiksojnë geramat e turbullta, gjë që nuk është aspak e lehtë për ata të radhëve të prapme, por që valët e pëshpëritjeve përçojnë shpejt e shpejt ngado mesazhin, njëlloj sikur ta lexonim vetë. Në gjoksin e vajzës së parë zbukurohet mbishkrimi “NE”, tek e dyta fjala “JEMI”, tek e treta ndodhet mbishkrimi “AI” dhe tek e katërta “TERRENI”. Lektor, pasi kthen kokën anash, mbetet në pritje.

Pastaj i hedh sytë një rës prej vajzave dhe e pyet:

- E mbaruat?

Në këtë kohë vajzat me mbishkrime ulërijnë njëzëshëm, pastaj nisen rreth e për qark podiumit duke hedhur një lloj valleje, në fillim heshturazi, e më pas thërrasin diçka me zë gjithmonë e më të lartë, ndërkohë që nuk u besoj veshëve, por ndoshta vërtet përsërisin fjalët *unga-bunga*.

- Ç'kërkojnë këto? - pyet dikush pranë meje.

- Unga-bunga? - pyet një tjetër. - Shaka është kjo?

- Qetësohu, - kthehet prapa një i tretë i informuar mirë. - Kjo është një ndërhyrje.

- Tashmë besoj se mjafton, - thotë lektori në podium.

Pas kësaj, ata të radhës së parë, ndër ta edhe moderatori, ngrihen dhe i kërkojnë me forcë vajzave që të largohen, dikush i hedh një mbulesë një rës prej tyre, që vajzat vazhdojnë kërcimin dhe bërtasin, pastaj kur duket se prezantimi nuk do të mbarojë kurrë, ndërkohë njëra prej tyre ngre sërish dorën lart dhe vajzat ndalojnë, pushojnë zhurmën e tyre dhe tërhiqen në radhë si bëjnë rosat. Pastaj ka heshtje, lektori ende qëndron në podium me kokën poshtë, fërkon me forcë majën e hundës me dy gishta, sikur të kishte aty një valvul, e cila tani duhet të mbyllet që të mos dalë ajri jashtë. Marr guximin të betohem se kur ngriti kokën më ka parë mua në sy.

Gjatë pushimit të kafesë diskutojmë mbi skandalin e madh të konferencës, ndërkohë që gjysma e turmës bën gati plaçkat, pasi siç është bërë e ditur në fund, po ikin drejt plazhit të qytetit, e kuptueshme kjo kur mendon se një vit më parë fitoi çmimin e "Plazhit më të mirë të Vitit", dhe për më tepër pas orës katër pasdite hyrja kushton vetëm gjysmë çmimi. Mbeten vetëm më të rinjtë dhe më të vjetrit, si edhe lektorët e seksionit pasardhës. Shkëlqimi i diellit të pasdites së vonë na mbështjell të gjithëve në prarim.

Banketi në mbrëmje mbahet te restoranti pranë bashkisë. Organizatorët i kishin vendosur tavolinat në formën e germës U, si nëpër dasma, ku në vendin e çiftit të ri ishin ulur organizatorët kryesorë të konferencës. Kurse ne të tjerët mund të uleshim ku të kishim dëshirë. Por ama, të gjithë grupohen sipas statusit të ngjashëm me të tjerët. Megjithatë nuk kam ndonjë afërsi të madhe

me ata pak kolegë të paralelit të shkollës, me të cilët erdhëm në konferencë, madje ndoshta edhe të tjerët po të tillë ndjesi kanë për njëri-tjetrin, sikurse edhe unë, prapëseprapë shkojmë tutjetëhu duke u ngjeshur bashkë, bëjmë çdo gjë së bashku, sikur të na duhet të tregojmë që askush prej nesh të mos mbetet vetëm as për një moment.

Ndërkohë që presim pjatat, atij që më ndodhet pranë i flas rreth konviktit. Levente Vadkerti përballë meje fërkon pjatën e tij boshe dhe me gjysmëbuzëqeshjen ëndërrimtare dëgjon leksionin e vogël që po mbaj për zakonet e konviktoreve të katit tonë në raport me insektet apo për gjendjen katastrofike të mjediseve të përbashkëta që kemi. Ndihem në formë, po karikaturaj dhe polarizoj gjendjen dhe nuk ndihem e trembur nga hiperbolizimet e vogla apo perspektivat imagjinare. Ata që më ndodhen pranë vënë buzën në gaz, kurse Levente vazhdon ta sjellë vërdallë gishtin tregues nëpër cepat e pjatës që ka përpara. E njoh mirë këtë lloj dore dhe nuk më pëlqen aspak. Sikurse as koka ovale prej adoleshenti. Si person e pëlqej, por më hyjnë mornica nëse imagjinoj se e dashuruar duhet ta puth trupin e tij nga maja e kokës deri te majat e gishtave.

Që është i dashuruar me mua, këtë e dinë të gjitha grupet paralele dhe kjo u fal njëfarë rehatie të përgjithshme. Ndoshta ngaqë e shohin se sa nuk do të shkonim po të ishim bashkë si çift? Apo pikërisht për të kundërtën, ndoshta sipas tyre do të shkonim shumë? Apo ndoshta u duket për të qeshur që Levente nuk i fsheh ndjenjat, madje krenohet me to? Kjo pa dyshim që duket komike, por për mua është më tepër e frikshme, sidomos kur fillon të më vërtetojë se më vonë, një ditë të bukur, do ta shoh se ai është i dhuri për mua. Përse mos ta pranoj këtë? Di ndonjë gjë Levente që unë nuk e di? Nuk di, por kështu përpiqet të manipulojë? Ç'do të ndodhte po të rezultonte kështu? Më bezdis që qenka kaq i sigurt për të ardhmen tonë të përbashkët. Më kot përpiqem t'i shmangem besëtytnive të familjes sime, nuk qenka e mundur të mos kem frikë nga mallkimet, profecitë, apo magjitë e zeza të fjalëve.

Deri para pak vitesh, Levente ushtronte vaterpolon si profesionist dhe kjo duket qartë kur i hedh sytë. Nëse njëherë e

një kohë do të shkoja në shtëpi për dore me një djalë me pamje të tillë, babai im do të qante nga gëzimi. Këtë do t'ia impononte sidomos vaterpolo. Vërtet, përderisa në Bekashmegjer nuk ka pasur pishinë sa ishte gjallë im atë, as nuk mund të shpresonte për ndonjë vaterpolist. Jo aq shumë as për sportist. Po përse e ndërron dikush vaterpolon për sociologjinë? Sipas thënieve të Leventes, mbërritja këtu ka ndodhur si pasojë e një serie aksidentale. Për shembull ka ndjekur një program të orës së vonë në kanalin e dytë, nga i cili i ka rezultuar ajo që nuk e kishte menduar kurrë, se bota e sportit profesionist është e korruptuar dhe se trupit të njeriut nuk i bën mirë një sforcim i këtij niveli. Këto ka menduar. Më pas, gjyshja e Leventes i ka dhuruar për ditëlindje nipit të vet abonim në një revistë letrare apo të jetës publike. Po në atë vit në klasën e Leventes ka ardhur një mësues i ri historie, i cili në dallim nga ai i mëparshmi, ka qenë pedagog i mrekullueshëm. Me këtë mësues Levente fliste gjatë dhe nga ai ka dëgjuar për herë të parë për sociologjinë. Mendimi i parë që i ka ardhur ka qenë se mund të jetë një prej degëve të mjekësisë, ma ka pranuar këtë duke qeshur, kurse unë qeshja me të.

Levente nuk e di se çfarë kuptimi ka, në të vërtetë, ngjarja aksidentale. Nuk e di, sepse nuk ia kam thënë që as unë nuk kisha dëgjuar për sociologjinë deri në maturë, dhe po përgatitesha të bëhesha parukiere në një sallon bukurie, sepse mamaja më kishte premtuar që do të ma rregullonte. Gjatë dimrit Levente besonte, madje ndoshta ende mendon se jam nga Segedi, që jam pasardhësja e zgjuar, por dembele, e një familjeje të ngritur nga Segedi. Nuk e di përse e beson këtë, por nuk më vjen keq. Nuk jam mësuar të flas për Bekashmegjerin, ngaqë nuk dua të shoh shtangien e frikësuar në sytë e të tjerëve. Nëse dikush më pyet, nuk ia fsheh, por për fat të mirë kjo ndodh rrallë.

Pasi sjellin darkën, për njëfarë kohe harrohem i tek e ngrëna, e pastaj Levente fillon të shfrejë thashethemet për lektorët që ishin në konferencë. Është i mirinformuar, sepse ka marrëdhënie të mira me shumë pedagogë. Është tipi që pasi mbaron ora e leksionit shkon te lektori, fillon bisedat, frymëzohet, përkëdhelet. Për mua kjo është e sikletshme, por ai mendon që jo. Duket sikur nuk është e sikletshme as për mësuesit; ata i buzëqeshin, ia kanë mësuar

emrin, e përshëndesin nëpër korridore. Një pjesë të historive e kam dëgjuar tashmë, madje disa prej tyre për të disatën herë, por prapëseprapë më vjen për të qeshur me to, ngaqë Levente di t'i tregojë bukur. Ekipin tonë e sjell në qejf darka, qeshim pa fund. Sikur të ishim vërtet në ndonjë dasmë, ku kamerierët pa u lodhur na vendosin përpara pjatat e radhës dhe alkoolin. Ngrënia dhe pirja prej orësh e japin efektin e tyre, mbërrijmë në një të tashme gjatësisht magnetike, jeta bëhet e bukur, këmbët na enjten, fytyrat na djegin, pulsi na rritet dhe fytyra na merr ngjyrën portokalli, ashtu si edhe dritaret me xhama po portokalli, llambat portokalli dhe panelet portokalli.

Nuk e di prej sa kohësh ka aty, por në momentin e ëmbëlsirës pranë Leventes është ulur një burrë, i bëshëm e i mbledhur, ndërkohë që i tregon diçka duke bërë gjeste të mprehta me duar. Nuk dëgjoj asgjë, ka shumë zhurmë dhe muzika vazhdon, në një kohë që një pjesë e grupit tani po kërcen.

Nga shoku i ri i Leventes më vjen ndër mend qeni Mutlej nga një serial i vjetër vizatimor, "Vrapi Fluturues", ku përqesh duke e futur kokën mes shpatullave. Po në të njëjtën mënyrë nënqesh edhe burri në fjalë, ndërkohë që flet e flet pa pushim, duke i dhënë rrjedhë me një kënaqësi të dukshme fjalëve që nxjerr nga goja, e shformon gjuhën sikur do t'i rimerrte sërish të gjitha përpara se ato t'i vendoste në dispozicion. Tani është Levente që përgjigjet, tjetri tund kokën, qeshin. Pas njëfarë kohe më bën përshtypje se që të dy po shohin drejt meje.

- Çfarë ka? - pyes.

- Eja pra pak më afër! - thërret ai njeri, dhe në kohë më formohet mozaiku, më në fund i bie në të se këta të dy po bisedojnë për mua prej minutash të tëra, ose më saktë për dashurinë që Levente ndien për mua, dhe se ky njeri është i njëjti me atë që po shtjellonte virtytet e punës në terren dhe të hulumtimeve cilësore. As më shumë e as më pak, ky është Bogdani, ai që Levente përmendi se do të mbajë leksion, të cilit Levente nuk i lë seminar pa i shkuar, më ka ftuar edhe mua, por unë nuk kam shkuar, sepse frymëzimi histerik i Leventes m'i ngrinte shumë nervat. Në të qindtën e sekondës qartësohem dhe më përshkon një proces i veçantë. Ndërkohë, kur kuptoj se kush është, ai shkurtabiq, ashtu

siç e kisha parë deri në atë moment, më zhduket në çast, format i shtrihen, fytyra i bëhet më me karakter, dhe e gjithë paraqitja bëhet ajo e goditura. Po ashtu paraqitja më vendos në siklet sa edhe trupi më drejtohet, gjinjtë më shtyhen përpara, kurse goja më zilepset. Nuk ishte vendimi im, nuk dua ta drejtoj trupin, nuk jam unë ajo që dua të shoh me sy të shndritshëm drejt këtij njeriu, këtij ndihmëspedagogu, që, me të vërtetë, po më flet, madje me afërsi aq të dukshme sikur të ishim miq për kokë.

Levente gjithë vitin më ka çmendur duke më treguar për të - Bogdani tha këtë, Bogdani tha atë, sipas Bogdanit sociologjia ndodhet në udhëkryq, se ndihet nevoja për shkenca sociale fleksibël, sepse edhe shoqëria ndryshon vazhdimisht, se një shoqëri nuk mund ta përshkruash nëpërmjet shifrave, ashtu siç e deklarojnë kokat e mëdha të sociologjisë, megjithëse tashmë edhe ata sikur të jenë në mëdyshje që sistemi ka gabime, megjithëkëtë kanë frikë të përballen me problemin, këtyre fytyrave karrieriste u intereson vetëm që të mbërrijnë te kazani i gatimit i mbushur plot, dhe që ta mbushin në kohë aty lugën e tyre të krimbur. Por mua nuk më hynin aspak në sy këto thërrime, as që i vija re, nga një vesh më hynin e nga tjetri më dilnin, imagjinoja përpara vetes një ndihmëspedagog, djalë të ri hollak, një mësues të zellshëm, ashtu siç e kisha parë kur shkova në një prej seminareve fillestare të shkollës, dukej që ishte vetëm disa vite më i madh se ne, e përmbylli vitin duke belbëzuar, e më pas e ngeli treçerekun e grupit. Besoja se Levente kishte përzgjedhur si objekt të lumturimit të tij intelektual një format të tillë njeriu, por kur bëhet fjalë për ndihmëspedagog, atëherë është tërësisht diçka tjetër.

- Vetëm doja të thosha, - përkulet mbi tryezë Bogdan Tamashi, pasi u afrova më tepër pranë tyre, - se ky djalë ka të ardhme të ndritur përpara!

Levente, me fytyrë të bërë prush, shfryn hundët, tund kokën duke buzëqeshur, duke e mbuluar tregon nga mësuesi dhe gogësin:
- Është plotësisht tapë!

Bogdan Tamashi më vështron si të isha e dashura e Leventes, gjë që për momentin nuk më bezdis. Më kërkon që t'i tregoj si po më duket konferenca. Është i interesuar të dijë mendimin tim. Flas duke i pranuar se nuk kam baza krahasimi, pasi kjo është

konferenca e parë ku marr pjesë, më pas i lavdëroj përzgjedhjen e vendit dhe e konsideroj simpatik nënkryetarin e bashkisë që hapi aktivitetin. I them se duket e mrekullueshme që kanë ardhur kaq shumë njerëz. Edhe leksionet ishin interesante. Për një të sapolindur, çdo shaka është e re, shtoj më pas.

Pas kësaj, Bogdani fillon të tregojë anekdota për lloj-lloj konferencash të ndryshme, duke vënë në shënjestër herë hulumtues karakteristike, e herë pedagogë universitetesh, mënyrën e leksionit të disa drejtuesve institucionesh, duke u imituar kthesat më karakteristike të timbrit të zërit, madje ironizon edhe vetveten. Nuk pushojmë së qeshuri. Në bazë të karikaturave duket vërtet i vëmendshëm ndaj detajeve, vëzhgues empatik, më pëlqen për aftësinë që ka për ta parë së jashtmi veten dhe atë që e rrethon, kurse vështrimin pa dyshim nuk e ka tallës apo lëndues. Filloj të kuptoj përse Levente e pëlqyeka kaq shumë. Flet gjatë, monologët i ka gjithmonë e më të vështirë për t'ia ndjekur, ndërkohë që në kokë më bie pija dhe zhurma e muzikës bëhet përherë e më e lartë. Kolegët e paralelit na hedhin sytë herë pas here, e ndoshta habiten që si ka mundësi që një pedagog të flasë kaq gjatë me ne, sikur të mos ishim vogëlushët e vitit të parë.

Fytyra e Bogdan Tamashit është pak topolake. Më përngjan ndoshta me atë të një ketri të rritur më tepër se zakonisht. Më ngec sërish vështrimi te shpatullat e rrahura, por sa shumë ndryshe që nga pasditja. Më pëlqejnë veçanërisht format e thonjve në duart mishtore. As të vegjël e as të mëdhenj, gjë që rrallë e ndesh. Ndaloj dhe e gjej veten shpesh duke vështruar lëvizjet intensive të duarve të tij. Gishtërinjtë herë në ajër i vibrojnë, e herë të tjera petëzohen në tavolinë në të dyja anët e pjatës, pastaj ngrihen vrullshëm, sikur i bien pianos, drejtojnë, ndiejnë muzikën, ulen poshtë. Dora e djathtë luan për njëfarë kohe me një pirun, pastaj me një lugë, e më pas prapë me një pirun. Edhe loja e plastikës e fytyrës së Bogdanit është e larmishme, është e vërtetë që po e dalloj këtë, sepse po tregoj vëmendje ndaj gjesteve dhe mimikës së fytyrës së tij, ndërkohë që tingujt as që po ia dëgjoj. Gulçon, tërhiqet, bën grimasa, vetullat i tunden, madje-madje i lëviz edhe hunda, i lëviz pa pushim, deri tani nuk e kisha vënë re, por pasi e pashë, nuk më hiqet dot nga mendja. Sidoqoftë, për çdo gjë që është duke folur,

arrij ta dalloj kur bëhet fjalë për ndonjë barsoletë. Dhe kjo ndodh shpesh. Në atë çast qeshim prapë të dy bashkë me Leventen dhe me vështrimin tonë i bëjmë me dije njëri-tjetrit se ky Bogdani qenka ç'qenka.

Në pushimin mes dy këngëve pushon edhe ai, që të largojë etjen me një gotë të madhe limonade. E gëlltit me gllënjka të zhurmshe.

- Më falni nëse pyetja është jo e veçantë, - i kthehet Levente mësuesit të tij, i cili shfaqet paksa i çuditur për shkak të fjalëve "jo e veçantë". - Dua vetëm të pyesë se kush ishin ato vajzat që hoqën bluzat?

Bogdan Tamashi ul gotën, kryqëzon duart dhe lidh gishtat. Ka diçka të ngjashme me nënoket te këto veprime që kryen, prandaj dalloj sikur shoh një gjë që nuk më lejohet dhe se njohja jonë tashmë është bërë tepër e afërt.

- Ato? - pyet pas një pauze të shkurtër. - Mendoj se janë ndjekëset feministe të Bërëndit.

Gruaja që lante flokët në tualetin e ndërtesës së bashkisë. Këto *ndjekëset e saj feministe* të ishin vallë përgjegjëse për këtë shfaqje të veçantë? Ashtu si më kujtohen në gjendje të mjegullt ngjarjet e pasdites, më çudit fakti që ndërhyrja përfundimisht është futur në programin e konferencës, sikur të mos kishte asgjë më të natyrshme sesa ndodhia ku katër studente të zhveshura vetëm me sutjena, duke kërcyer *unga-bunga*, kërcëjnë tej e përtej në podium me ritme indiane. Nuk ndodhi ndonjë skandal shumë i madh, nuk u largua ndonjë njeri duke u përndjekur, dhe tani pas kësaj nuk duket madje as e kuptueshme nëse ky ishte apo jo vërtet provokim, ashtu si m'u duk në fillim, dhe në vend të kësaj mos kemi parë një shfaqje teatrale, e cila kishte mbetur jashtë fletores së programit me qëllim që surpriza të kishte edhe më tepër efekt. Ndoshta të pranishëm këtu ishin edhe ata që u bënë thirrje vajzave që të largoheshin.

Mundet që këto ndjekëse feministe të ndodhen edhe këtu në restorant, ndoshta po shijojnë banketin së bashku me ne. Vë syzet që nxjerr nga çanta, edhe pas kësaj vazhdoj të shoh qartë dhe pavarësisht se kërkoj me ngulm rreth e përqark, nuk arrij

dot të dalloj nëse anëtarët e katërshe ndodhen aty në mes të të pranishmëve. Pastaj në kthesën më të largët të radhës së tavolinës në formën e gurmës U, më mbeten sytë të një vajzë, që duket ndoshta dy vjet më e madhe se unë, dhe po filloj më së shumti të dyshoj se ajo mund të ketë qenë njëra prej tyre, ngaqë dy karrige më tutje shoh të ulur Eniko Bërëndin. Flokët e shpërndarë andej-këtej ia mbajnë syzet e diellit të vendosura mbi kokë. Midis të dyjave është futur fiks si pykë një pedagog imi i mëvonshëm, një burrë i moshuar, për të cilin di vetëm që, ashtu si edhe unë, ka dy mbiemra, i pari me njëfarë rromuzi që nuk ia mbaj mend, kurse të dytin e ka shumë të zakonshëm. Mbiemrin e vjetër të veçantë nga mamaja, që ka origjinë aristokrate, e ka marrë pas ndërrimit të sistemit, e sipas Leventes, i gjithë universiteti qesh me faktin se që nga ajo kohë ka ndryshuar edhe pamjen e jashtme, ka lënë mustaqe të gjata me bisht, i është ngurtësuar një qëndrim krahëhapur, mban veshur kravatë të lidhur në formë Bajroni dhe jelek, ngjan sigurisht si Kont i humbur në kohë. Fillon të bisedojë me vajzën e dyshuar nga unë për kërcimin *unga-bunga*, por ama vajza vendos dorën përpara gojës dhe del me vrap nga salla. Burri sheh i trembur pas saj, sikur të kishte frikë mos e kishte shkaktuar ai këtë gjendje të keqe të menjëhershme, vështrimi fillon t'i lëvizë andej-këtej në drejtimin midis karriges bosh dhe derës së sallës. Hedh sytë nga Eniko Bërëndi, e cila i thotë diçka, me shumë mundësi për ta qetësuar se vajza është ndier keq vetëm nga e pira dhe i ofron një cigare.

Dal edhe unë për në banjë, por nuk përballem me atë vajzë. Pi ujë gjatë nga çezma. Kur kthehem, ngulem tek ana e tavolinës ku janë edhe Levente dhe Bogdani. Afroj një karrige dhe tundem duke u mbështetur te këmbët e bashkuara të tavolinave. Në ato momente Levente po tregon se si e ka bërë njërën prej detyrave të shtëpisë që ka dhënë Bogdani. Ka punuar më së shumti netëve, kur mamaja ka dashur me çdo kusht ta pengonte, prandaj ajo gjente lloj-lloj mënyrash, i përgatiste një litër çaj qetësues me bime kuruese dhe pas darkës i jepte çaj sanëze, ia kishte ndërruar shtrojat me më të buta, e kështu me radhë. Bogdani argëtohet me historitë e çuditshme dhe në një moment shton se *e dimë tashmë historinë me mamane tënde*.

Pas pak marr vesh edhe se Levente i raporton Bogdanit javë pas javë mbi zhvillimet në marrëdhënien tonë dhe të dy bashkë meditojnë për atë gjë, se sa mbetet deri te pushtimi përfundimtar, ndërkohë që Bogdani i jep edhe këshilla kolegut rinor. Ashtu si kthehet biseda te çështjet e jetës private, Bogdani përherë e më shpesh i lejon vetes shaka me kripë. Një pjesë e këtyre i përket kohërave të mëvonshme kur unë dhe Levente do të bëhemi çift dhe lumturisht as nuk do të ngrihemi nga shtrati i ngrohtë. Leventes i është bërë koka mavi, gati sa nuk mbytet nga të qeshurat, kurse unë vë buzën në gaz duke ngritur njërin nga vetullat, duke shprehur kështu dyshimet e mia në mënyrë të dallueshme, por megjithatë nuk bie pre e shakasë. Ndërkohë që shkrep pamje të ndryshme për të ardhmen tonë të përbashkët, i vijnë ndër mend histori mbi të kaluarën e vet, mbi të dashurën e parë që ka pasur, pastaj për të dytën, e cila më pas u bë edhe bashkëshortja e tij, që nga ajo kohë janë ndarë, vë në dukje, dhe për çudinë time fillon të tregojë se sa të lirshme e ka pasur jetën seksuale me të dashurën e parë. Se pavarësisht që ishin adoleshentë, i ngrohte kërshëria e zbulimit dhe etja e dashurisë dhe tashmë po i vjen habi sesi nuk kanë pasur tabu në lidhjen që kishin krijuar. Do ta pyesja me dëshirë se përse u ndanë, por nuk guxoj. Pastaj shkon edhe më tej, duke e cilësuar si të veçantë atë të dashur të parë, pasi më vonë e mësoi se në lidhje me seksualitetin e vajzave fshihen rreziqe serioze, atyre u mbivendoset matura, i largohen seksit, nuk është vetëm faji i tyre, por është edhe çështje socializimi dhe në, fund të fundit, flasim për një fat tipik femëror, i cili duhet shmangur, dhe nëse mund të më japë një këshillë, thekson, dhe më hedh vështrimin, se do të ishte më mirë të mos jem e ndrojtur, kaq.

Nëse do të ma kërkonte aty për aty mendimin, as që do të mund të nxirrja ndonjë tingull nga goja. Por ai nuk ndalon dhe pa marrë frymë vazhdon më tej, ndërkohë që fillon të hajë prapë, përtyt ushqimet e mbetura e të ftohura, dhe si pa e vënë re, kthehet të merret me gjatësinë dhe formën e veçantë të veglës së tij. E gjendur si në faj, filloj të pi raki me gotë uji. Se sa pikëllim i ka sjellë si adoleshent ai harku, nuk e kuptonte përse nuk e kishte të drejtë, se me pak ekzagjerim mund ta quajë se ishte si çengel, por duhet të kishim kujdes, se kjo pengesë e dikurshme tani është bërë përparësi.

Mu në mes të fjalisë dikush i rreh shpatullat. Mund ta ketë ndonjë koleg të vjetër, Bogdani ngrihet, përshëndeten me njëri-tjetrin, bisedojnë. Për një moment, bashkë me Leventen na kaplon heshtja, presim që të ulet sërish. Kalojnë minuta. Pastaj bëjmë tek-a-çift, dhe as në këtë kohë nuk flasim për asgjë, as se për çfarë temash diskutimi ishin në tryezë.

Pastaj në një pikë vërej se Bogdanin e ka përthithur hapësira. Më duket sikur jam ulur një ditë të tërë në restorant. Ndoshta duhet të dal për te hoteli, por sipas orës së dorës, është vetëm nëntë e gjysmë. Dëgjoj Leventen të thotë se Bogdani është gjithnjë një i pahijshëm i tillë.

- Ti e kuptove se kush janë feministet e Bërëndit? - e pyes.

Shoh për nga Eniko Bërëndi. Është po aty, nuk ka lëvizur, ulur në anën tjetër të tavolinës, dhe duke pirë cigare dëgjon mikun ngjitur me tre emra që shpjegon, tani që flet me trupin e kthyer tërësisht drejt saj, pamjen e fytyrës e ka si të zënë në faj, thith edhe njëherë cigaren, që i ka shkuar deri te filtri dhe pastaj e shtyp me një lëvizje të pafuqishme në tavllë. Eniko Bërëndi pastaj prek pjesën e mbetur nga cigarja, që digjet ende, dhe e shtyp me forcë pa i hedhur vështrimin. Tani po më bie ndër mend që i kam akoma syzet në sy.

Leventes i vjen për të qeshur.

- Kjo është gjeniale! E sulmoi Nagj-Sentivanji!

Më duket sikur duhet të jem në dijeni se kush janë këta njerëz.

- Nuk i duroj dot gratë e tilla, - thotë Levente.

Ky tingull zëri poshtërues është disi i pazakontë për të. Zakonisht nuk bën komente për askënd, të paktën jo përpara meje. Në përgjithësi i për zgjedh fjalët, është i kujdesshëm, shpesh emocionohet se mos nxjerr ndonjë gafë nga goja. E vërteta është që këtë mbrëmje këto cilësi nuk i dallohen.

- Çfarë? - e pyes.

- Njëkohësisht edhe flegmatike, edhe snobe, - përgjigjet pasi mendohet shkurtimisht.

- Nuk është mendimi yt ky, - i them. Nuk e kupton, ose nuk e dëgjon.

Eniko Bërëndi nuk duket si miss së jashtmi, nëse do ta dije: mund të duket një miss një grua që lau flokët në tualetin e bashkisë dhe tani po dëgjon me durim njeriun me tre emra, që thonë se

është i lodhshëm, atë farë Nagj-Sentivanjin. Nuk duket sikur është kushedi në qejf, pamjen e fytyrës e ka vërtet flegmatike, duke i fryrë njëherazi tymit të cigares. I vendos syzet në çantë.

- Shiko Levente, nuk e di se kush është kjo grua, - i them ndoshta me një ton më të ashpër se sa duhet.

- E po Eniko Bërëndi, - përgjigjet Levente.

- Po nga duhet ta dija se kush është kjo Eniko Bërëndi? - ia kthej me pyetje.

- Jep mësim në universitet, ja andej, - thotë. Pastaj me zë më të ulët, pëshpërit: - Ka qenë e dashura e Bogdanit.

- Sikur ta merrja me mend, - i përgjigjem, por, në të vërtetë, as e kisha çuar nëpër mend.

Levente tund kokën sikur bie dakord. Pastaj, pa e pyetur kush, fillon të flasë për të. - Është rreth të tridhjetave, është pjesë e brezit të humbur, pjesë e të cilit nuk është Bogdani, sepse është thujse dhjetë vjet më i vjetër se Bërëndi. - Se ç'kuptim ka brezi i bumbur, nuk e marr vesh, por as që marr mundimin të pyes. - Për Bërëndin duhet ditur se, - thotë Levente, - është bushtra me nam e shkencave sociale.

Nuk di të them nëse e kam dëgjuar ndonjëherë nga goja e Leventes fjalën bushtër. E tronditur mund të shoh që duke belbëzuar kërkon të më vërtetojë se Eniko Bërëndi e ka merituar këtë titull. - Po, po, dhe dihet mirë, - thotë Levente, - gjatë karrierës së saj është lidhur me dy pedagogë që ka pasur për të fituar poste, kurse tani e reklamon veten përpara studentëve të saj meshkuj. Mënyra si ecën nëpër korridore, si kërcet takat në auditor, si niset duke dalë nga ndërtesa e universitetit, si i hedh flokët kur hipën në makinë, - po ja që i ka flokët e shkurtër, - e ndërpres, - më përpara i ka pasur të gjatë, - thotë Levente, - me një fjalë i jep disa shikime studentëve të saj, që ata ta ndjekin si somnambul. Meqë ra fjala, është pasardhëse e një familjeje gjysmë hebreje nga Buda, në të cilën të gjithë janë me famë, kështu që pa dyshim edhe asaj i duhet të jetë e tillë. Po ama me këtë furtunë është e vështirë që të realizohet. E di çfarë, këta janë ata tipa njerëzish që i gëzohen vazhdimisht gjenialitetit të tyre, çdo minutë shkrihen, që të tregojnë se sa gjenialë i kanë fëmijët, sa gjenialë i kanë nipërit e mbesat, edhe argëtimin e kthejnë në diskutime, dhe nëse ndonjë

shkrimtar bashkëkohor hedh ndonjë fjalë diku, janë të parët që informohen për këtë dhe madje fillojnë ta diskutojnë gjatë tryezës së darkës. Ama Bërëndi nuk ka ndonjë hulumtim të shquar që ta ketë çuar fund e krye, ka vetëm ndoca seminare postmoderne dhe një çerek libri të shkruar, por sipas gojëve të liga, po ia bëjnë gati kolltukun e kryetares së Shoqatës Hungareze të Sociologjisë.

- Çfarë anëtare e brezit të humbur qenka, kur tridhjetë e disa vjeç do të bëhet kryetarja e Shoqatës së Sociologjisë?

- Jo në atë kuptim e humbur, - tund kokën Levente. - Bashkëmoshatarët e saj janë edukuar në sistemin e kaluar, por kur kanë dhënë provimin e diplomës, fiks filluan kohët e reja, me një fjalë këta njerëz, në të vërtetë, nuk ndihen plotësisht në shtëpinë e tyre në asnjë sistem, mosha madhore e rinisë që kishin iu dogj dhe pjesa më e madhe nuk arriti të plotësohet, të krijojë familje, si ndodhi me ata të para pesë ose dhjetë vjetëve.

E kuptoj, por edhe jo. Ndoshta kështu ndihet edhe vetë Levente.

- E kush janë feministet e saj?

- Mendoj se i ka studente.

Bëhet vonë, në kamp kthehen të mëdhenj e të vegjël të konferencës. Shtrihem në një tavolinë pingpongu, shtrij duart e këmbët dhe këndoj. Të tjerët nga paraleli im hidhen përçark tavolinës dhe duke imituar pamjen e tenisit nga *Zmadhimi*, hedhin-presin pa topa. Shkumëzojnë me gjuhët e tyre kur godasin topin imagjinar, tundin me lëvizje të gjata raketat imagjinare, duke imituar goditjet e topit pas shërbimeve të vështira. Vërej në një pikë se ka hyrë në radhën e lojtarëve edhe Bogdan Tamashi, madje pas një kohe po luan pingpong me ta edhe Nagj-Sentivanji. Më zë gjumi dhe filloj të ëndërroj. Kur e marr veten, loja ka ngecur dhe pranë tavolinës ka rënë nga një karrige plastike e bardhë Bogdan Tamashi, dhe po aty ndodhet dora vetë Eniko Bërëndi, më ka kthyer shpinën, mbështetur në tavolinë, kurse Bogdan Tamashi e sheh dhe i hedh tymin. Ngrihem ulur.

- Është viti dy mijë dhe unë jam fiks njëzet vjeçe, - them.

- Të uroj nga zemra, - thotë Eniko Bërëndi, duke më parë. E hedh tutje bishtin e cigares dhe niset drejt shtëpive prej druri.

2.

Verën e vitit 1999, Eniko Bërëndi mbërriti për herë të parë në Budapest që prej kohës kur ishte zhvendosur në Nju-Jork. Ndonëse atë kohë ishte betuar që nuk do ta vendoste më këmbën në këtë vend. Çfarë e bëri të ndryshonte mendje? Lajmi për mbërritjen e saj kishte marrë dhenë edhe te të njohurit e saj më të largët, dhe nga premiset disa kishin nxjerrë si përfundim se kjo nuk është një vizitë e thjeshtë, ky është rikthim. Shkaku i rikthimit me shumë mundësi është fakti se martesë i kishte shkuar keq. E nëse ky ishte realiteti, nëse i shoqi me lidhje në Nju-Jork ia kishte pirë lëngun, gjë që nuk do të ishte habi, atëherë edhe karriera e përtejoqeanit kishte përfunduar për Eniko Bërëndin.

Kjo nuk ka mundësi, hidheshin të njohurit më të largët. Ky tip njeriu përfiton edhe nga situatat më mjerane. Edhe sikur të mos ketë bërë asgjë për dy vjet, sikur vetëm të ketë pirë cigare në ballkon dhe vetëm të ketë zbukuruar thonjtë, prapëseprapë ia del të nxjerrë më të mirën. Mendimet e pjekura gjatë i hedh në kartë papritmas, nga të cilat del një ese, studim, ndoshta edhe ndonjë libërth i vockël, dhe hopa, i është përkthyer edhe në anglisht. Niveli i veprës është për t'u dyshuar, kuptohet, por për këtë nuk do të mërzhiteshin të njohurit më të largët, nëse dikush tjetër do ta shkruante atë, do të merrte pa dyshim po të njëjtat lavde.

Këta kështu janë të ndërtnuar. Gjyshja u pasurua gjatë socializmit nga fakti që shkruante romane për vajza të vogla, babai jep mësim filozofie në Berlin, dhe madje ekziston një artist pianoje me mbiemri Bërënd, si edhe një fizioterapist reformator i njohur ndërkombëtarisht. Eniko natyrisht që ishte nxënëse e shkëlqyer, në gjimnaz fitonte konkurset e shkollës, në moshën 27-vjeçare mori titullin doktore shkencash, dhe sa hap e mbyll sytë u bë ndihmëspedagoge. Kujt i intereson se këtu pati dorë edhe një profesor në prag të pensionit, i cili emërtimin ndihmëspedagoge ia caktoi si dhuratë dashurie. Sigurisht, kjo nuk shkoi shumë gjatë.

Në skenë u shfaq një artist amerikan performance, i cili mund të ishte maksimumi nja dhjetë vjet më i ri se profesori, por për fatin se përtej oqeanit prej kohësh ishte përhapur mënyra sportive e jetesës dhe ushqimi plot me rosto, dukej më i ri se tridhjetëvjeçarët e këtejshëm. Eniko u zhvendos në Nju-Jork, mori një bursë postdoktorale në universitetin “Columbia”, dy vite më vonë jepte mësim seminaresh në “New School” dhe publikoi analiza krahasimore në botimet e përhershme më të rëndësishme të shkencave sociale mbi formësimet e gazetarisë, apo mbi pikat e mundshme takuese të shkencave performuese dhe atyre sociale. Nga këto, asnjë nuk u botua në hungarisht.

Në verën e vitit 1999 u kthye në atdhe. Ky fakt nuk i tronditi edhe aq të njohurit e largët të saj. Lumturia që ndienin për faktin se nuk i kishte ecur martesë me amerikanin zbehej nga lajmi se Eniko kishte fituar punën në universitet dhe se po shkruante një libër me hulumtimet e saj. Shumë shpejt ishte e pranishme në të gjitha aktivitetet e rëndësishme profesionale, u shfaq në darkat shtëpiake të inteligjencës formësuese të opinionit, dhe për disa javë shërbeu si mësuese ndihmëse vullnetare në një kamp të organizuar për fëmijët ciganë të shtresës së varfër shoqërore. Mbi këto përvoja do të publikojë një seri letrash me interes letrar gjatë vjeshtës.

- Kujtoja se kishim të bënim me ndonjë sociologe, - thotë Rexhina Horvat, kolege nga rrethet, ndihmëspedagoge e përrjetshme në Universitetin e Debrecenit, dhe e hedh mbrapsht gazetën mbi komodinën e natës. - Nëse dikush mund të shkruajë studime të denja atëherë përse e harxhon kohën kot me të tilla broçkulla.

- Mbase kërkon t'i drejtohet një audience më të gjerë, - përgjigjet Kornel Ivanka, i dashuri i Rexhinës, i sapoemëruar ndihmëspedagog edhe ai në Universitetin e Debrecenit. - Ç'të keqe ka këtu? Ka kohë të shkruajë edhe për profesionistët.

Kornel Ivanka as njëqind e gjashtëdhjetë i gjatë, tanimë tërësisht pa flokë, dikur ka qenë shok grupi me Eniko Bërëndin, ky është shkaku që edhe tani shfaq simpati ndaj saj. Nuk e kanë njohur aq shumë njëri-tjetrin, por do të ishte gabim të mohojë se Eniko ishte qendra e padiskutueshme e koordinatave të orëve,

jepte shpesh mendim për lëndët, pyeste dhe nuk rrinte vetëm ulur si indiferente, ashtu si bënte shumica e studentëve.

- E po nuk ia vlen të shkruash kaq sipërfaqësisht, kjo vetëm i ngatërron lexuesit, - vazhdon Rexhina, dhe ndonëse nuk kishte dëshirë të binte në sy e tha me zë të dridhur. Po përse nuk e sheh Korneli, e përse nuk e shohin që të gjithë se ajo që po bën kjo grua është dritëshkurtësi? Do ta shprehte me aq dëshirë, do ta rendiste pikë pas pike, do ta argumentonte se çfarë e inatoste te këta lloj njerëzish, por meraku i vetëm ishte se ndoshta burri do ta keqkuptonte dhe do të besonte se e bënte nga xhelozia.

Rexhina nuk është xheloze, këtë ajo e hedh poshtë vendosmërisht.

- Mos më keqkupto, nuk po flas nga xhelozia.

- Patjetër, është e qartë, - përgjigjet Korneli, ndërkohë që mbush nga një gotë me lëng molle dhe më tepër ia shtyn përpara Rexhinës.

- Vetëm se nuk më duken të arsyeshme këto suksese, ky, - dhe Rexhina duket sikur kërkon shprehjen më të goditur, - entuziazëm i shfrenuar.

Që përpara se të nxirrte në dritë ndonjë gjë, Eniko Bërëndi mori në mënyrë të paarsyeshme vëmendje të skajshme. Për herë të parë u takuan në një konferencë të organizuar për studentët doktorantë, në atë kohë edhe këto aktivitete mbaheshin më formalisht, ndërkohë që i duhej përmbajtur disa rregullave të pashkruara dhe më të rinjtë tregonin respekt për më të vjetrit. Në atë kohë Eniko ishte ende duke shkruar disertacionin e saj, ndërsa Rexhina sapo ishte bërë ndihmëspedagoge. Ndhmëspedagoge! Po e çmendte krenaria, kërkonte me entuziazëm të gjente shoqërinë e ndihmëspedagogëve të tjerë, si ata që, më në fund, luajnë futboll në të njëjtën kategori, dhe shpresonte që me leksionin e saj të tërhiqte vëmendjen e dy-tre përfaqësuesve më spikatur të fushës. Nuk po ëndërronte për të pamundurën, për shembull që ta vinin re kolosët e shkencave sociale, me një fjalë ishte e qartë për pozicionin e saj.

Eniko, nga ana tjetër, e dërrmoi të gjithë sistemin. Po ja që, me ç'të drejtë po jepte leksion në konferencë? Si një studente universiteti? Si ka mundësi që organizatorët ia kishin pranuar

aplikimin? Përfundimisht si i kishte ardhur ndër mend që të aplikonte? Por dushi i ftohtë për Rexhinën do të vinte vetëm pas këtyre, pasi Eniko mori pyetje dhe komente nga shumë të interesuar, ndërkohë që këta komentues ia dinin edhe emrin. Profesori Hazman, kocka e vjetër e Universitetit të Debrecenit drejtpërdrejt e nisi prezantimin që dëshiron të komentojë ndaj leksionit të koleges Bërënd, dëshiron ta përgëzojë se këto i ka arritur në moshë fare të re dhe le të vazhdojë kështu, ndërkohë që në fytyrë iu shfaq një buzëqeshje miqësore. Kjo buzëqeshje jepte mesazhin që profesori Hazman e njihte Enikon, nuk po takoheshin tani për herë të parë, dhe se Rexhina e pranonte këtë, ndoshta asokohe ka ndier xhelozin, sepse profesori Hazman nuk ia mësoi emrin asaj përgjatë disa viteve rresht, gjë që natyrisht nuk përbën tragjedi, sidomos po të mbahet parasysh se po flasim për persona të alkoolizuar në të kaluarën. Jo, jo, kjo pa dyshim që nuk ka qenë xhelozin. Një parullë me germa të mëdha pulsoi në ekranin imagjinar të Rexhinës: **DIÇKA NUK SHKON!**

E ka parë sërish në një mbrëmje miqsh vite më vonë, kur kishin shkuar për vizitë në Budapest për shkak të një kërkimi shkencor. Rexhina po bëhej gati për një mbrëmje të qetë, me biseda dhe duke dëgjuar muzikë, aty ku kishin ftuar Kornel Ivankën, që e mori me vete, sapo kishin filluar të punonin së bashku. Darka e qetë, me biseda e muzikë kishte filluar bukur, në sfond kishte xhaz, kurse të pranishmit po flisnin gjatë për revistat e reja letrare ose për ato të shkencave shoqërore e kulturore. Rexhina ndiente se po mësonte shumë, sytë po i hapeshin dhe do të kishte vrapsuar menjëherë te kioska më e parë që të mbushej përplot me këto revista të reja. Por pastaj hynë aty nja pesëmbëdhjetë vetë, midis tyre edhe Eniko, fikën dritat, ndryshuan muzikën, sikur kishin rënë nga një rit shamani, kështu e ndjeu veten. Gjatë gjithë darkës Eniko u ravijëzua në mes të dhomës, kërcente shumë dukshëm, ndërkohë që e linte veten me qejf e pa qejf, që t'i ngjiteshin pranë, ndërkohë që në atë kohë, siç rezultoi më vonë, kishte dalë në skenë profesori i moshuar, emrin e të cilit Rexhina me takt nuk e nxjerr nga goja. E pabesueshme që Korneli nuk e vuri re as në atë moment se Eniko po e zotëronte mbledhjen e njerëzve, e zotëroi gjithë mbrëmjen, dhe në thelb e përthithi ajrin përreth të të gjitha

vajzave të pranishme aty, a thua se ishin kthyer në persona të padukshëm.

- Unë edhe atëherë vetëm ty të shihja, - thotë Kornel Ivanka.

- Më vjen mirë për këtë, - përgjigjet Rexhina, dhe ndërkohë ndien t'i nxeht koka menjëherë, sepse Kornel nuk arrin ta kuptojë se për çfarë po flet ajo. Se ekziston rasti që një grua t'i bëjë të padukshme vajzat e tjera. Dhe Eniko as nuk është e pashme, kokën e ka të madhe si të kalit, mendon, por këtë mendim ia kursen të tjerëve. (Mundet që ajo të jetë e vetmja në këtë vend të mjerë që t'i jetë mbushur kupa me Eniko Bërëndin?) Nuk po i tregon tani Kornelit as se çfarë ndjesie ka qenë të shihje nga fillimi në fund se si kjo grua i vardisej Bogdan Tamashit. Sepse ajo e ka parë, ka qenë dëshmitare e gjallë e kësaj ndodhie. Ndonëse ato ditë e patën fillimin fantastik. Ishin rreth njëzet vetë të mbledhur bashkë në atë shtëpi të bukur me verandë, me sebpin e ndjekjes së eklipsit të diellit. Kush nuk gjente vend brenda, e gjente veten me çadër në kopshtin përpara, dhe disa syresh fjetën edhe rrëzë mullarit, duke e bërë shtratin me kashtën e gjetur dhe mbrëmjeve ndiznin zjarr si nëpër kampe, ose shëtisnin deri te bari i fshatit, njiheshin me vendalinjtë dhe fushin monedha në xhuboks. Shtëpia ishte e familjes së burrit të njëfarë ekonomisteje me emrin Karola Zimanji, në të ishin varur kudo, duke filluar nga niveli i dyshemesë e deri në tavan, panorama që i kishte pikturuar vjehrra e Karolës. Shoqëria përbëhej kryesisht nga sociologë, Rexhina njihnte disa më tepër, ndër ta edhe Bogdan Tamashin, të cilin e konsideronte si djalë të zgjuar e simpatik. Vitet e fundit edhe atë e kishte shtrydhur jeta dhe bisedonin shumë mbi faktin se si e shtrydh jeta njeriun pas të tridhjetave, e pastaj mbi të dyzetat e moshës. Më pas në bisedë u fut Eniko, dhe ndodhi po e njëjta gjë si në atë mbrëmjen e famshme mes miqsh. E sforcoi, e shtrëngoi, e përthithi, e përvetësoi.

Që nga ajo kohë, lidhjen e tyre e kanë marrë vesh të gjithë. Shumë-shumë mund të bëhet tifo që Bogdan Tamashi të përdorë katapultën nga kjo lidhje poshtëruese, e destinuar të vdesë sipas çdo parashikimi, sa më shpejt të jetë e mundur. I gjori djalë. Aty në verandë tregoi se si u ishte prishur lidhja që kishte me gruan, nuk kishte shumë që kishte ndodhur, maksimumi një vit e gjysmë.

Edhe gruaja ishte nga rrethinat, kishin ardhur bashkërisht nga qyteza Baja, dashuri adoleshentësh, për fat të keq të tilla lidhje as sot nuk i mbijetojnë dot ardhjes në kryeqytet. Nuk ishte ende gati për lidhjen pasardhëse, dhe aq më pak me një grua të tillë, e cila kishte kërkesa, pranë së cilës nuk mund të relaksohej dot. Me një fjalë, Rexhina nuk i jep shumë të ardhme të gjithës kësaj.

Disa javë më vonë e pret me një hungërimë dyshuese kur dikush i tregon se Bërëndi dhe Bogdani po shkojnë kudo bashkë. Edhe ajo vetë do të jetë e pranishme kur çifti shfaqet bashkë në konferencën vjetore të sociologëve. Tre muaj më vonë tashmë japin leksion të përbashkët në një konferencë tjetër mbi mënyrën revolucionare të hulumtimit cilësor, dhe Rexhina do ta ndjekë edhe këtë eveniment. Vetëm më vonë do të marrë vesh se Bogdani dhe Bërëndi në lidhje me temën marrin pjesë në një *workshop* dyjavor në Gjermani. Mbi përvojat e mbledhura aty publikojnë edhe një studim të përbashkët. Sa hap e mbyll sytë dalin në pah si përfaqësuesit kryesorë kombëtarë të metodave cilësore të studimit, të paktën sipas të gjitha gjasave ata kështu e konsiderojnë veten. Mbase e mendojnë veten si çifti i ëndrrave të sociologjisë kombëtare? Aty ku mbijnë, nuk para flet njeri tjetër. Pas një aktiviteti të tillë profesional, Rexhina është e detyruar të pranojë se jo vetëm Bërëndi, por edhe Bogdani me dëshirë fillon të nxjerrë fjalë boshe për t'u mbushur mendjen të tjerëve. Ndërkohë që burri thotë gjithë ç'ka për të thënë, gruaja mjaftohet me faktin që të tundë kokën dhe të ketë vëmendjen aty për të, maksimumi herë pas here të ndërhyjë në rast se harrohet ndonjë detaj i rëndësishëm, për të cilin duhet folur se s'bën. Do të gëzohej Rexhina vallë po ta dinte se vetëm pak muaj më pas do të merrte shijen e parë të ditëve të fundit të lidhjes? Se do ta shihte me sytë e vet se si përulet Bogdani para opinionit të Bërëndit dhe që sillet pa respekt me të? Se mund të jetë dëshmitare e shkatërrimit të Eniko Bërëndit? Çfarë do t'i thoshte pastaj Kornelit? (Më vjen keq paksa për të varfrin.)

Në korrik të vitit 1999, Eniko Bërëndi përqafton edhe njëherë të fundit burrin e saj në aeroportin "John F. Kenedy", dhe duke bërë hapin prapa nisjet drejt kontrollit të bagazheve. Një yll kinemaje

i moshuar dhe një grua sllave me fytyrë ekzotike. Këmisha e hapur e Xhon Palmerit, me duart në bel, kurse balli i ndriçon bukur. Sikur po bën pushimin e shkurtër gjatë punës në kopshtin e shtëpisë. Më pas ngre njëren dorë deri në nivelin e shpatullës, e mban aty të ngecur dhe përshëndet gruan e tij që po largohet.

Kohët e fundit po e imagjinonte sikur të ishte mamaja e Enikos. Zëre se po paketonte në vend të saj, sillte njëren pas tjetrës ato rroba, për të cilat mendonte se Eniko nuk duhet t'i linte aty në asnjë rast. Ato të mbeturat i rregullonte gjithë kujdes në dollap, duke i përkëdhelur një e nga një këmishët, ato të natës, pantallonat. Duke mbërritur në aeroport, i mbajti deri në momentin e fundit të hedhura në kurriz dy çantat prej lëkure, shkoi të kërkonte pultin e imbarkimit, tërhiqte gruan duke i thënë që jo andej, eja këtej, këtu-këtu, kujdes aty, kalo këtu, dhe kur u futën në radhë, e vështroi me një buzëqeshje të çuditshme në fytyrë, iu lagën sytë, por nuk ishin lot pikëllimi, jo të një burri që do të mbetej paksa vetëm për një kohë të shkurtër ose të gjatë, por më tepër si të një prindi krenar, i cili është i prekur se sa e madhe i është rritur vajza, sa e zgjuar dhe e bukur i është bërë, dhe tani po niset të gjejë fatin nëpër botë. Nuk u surprizua aspak që bashkëshortja po e linte vetëm për një periudhë të pacaktuar, të paktën nuk e tregonte këtë, ishte burrë me përvojë, që kishte parë botën, dhe si i tillë, i di hopet e vajtje-ardhjeve, të ndenjjes dhe mbi parehatinë e personalitetit.

Eniko përshëndet, por me mendje është shumë larg, përtej kontrollit të sigurisë, përtej tualetit të parë që shfaqet përballë, përtej disa dyqaneve e bar-kafeve të shkëlqyeshme, ndoshta edhe pse jo në avion, por tashmë në kabinën luksoze të ndërtuar për cigarexhinjtë, ku mund të nxjerrë rrathët e tymit në rrethana të civilizuaras së bashku me amerikanët që nuk i ndahen zakonisht të keq të duhanit. Kështu zhduket përmes portës. Pranë saj një grua flokëshumë me pantallona kopshtareje tërheq valixhen, është e njohura e së njohurës së Xhonit; pak më parë u takuan të tre. Emrin e ka Jasmina, është këngëtare operash, apo mësuese joge, dhe do të udhëtojë së bashku deri te fluturimi tjetër, dhe kjo gjë Enikos nuk i pëlqen aspak. Nuk ia ka fare qejfi që minutat e para të lira t'i harxhojë me të njohurën e të njohurit vetëm për t'u dukur e sjellshme. Duke pritur për kontrollin e sigurisë ama përmendin të